NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Nesrin Lushta, kryetare, Agim Maliqi dhe Rasim Rasimi, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Sherif Krasniqi, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarve S.M. dhe Sh.Ç., për shkak të veprës penale në vazhdim falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit S.M., kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm P.nr.12/2017 të datës 29.08.2018 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.1013/2018 të datës 28.12.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më 14 maj 2019, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit S.M., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm P.nr.12/2017 të datës 29.08.2018 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.1013/2018 të datës 28.12.2018.

A r s y e t i m

Vendimi i Gjykatës Themelore

Gjykata Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin P.nr.12/2017 të datës 29.08.2018, të dënuarit S.M. dhe Sh.Ç., i ka shpallur fajtor për veprën penale në vazhdim falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së dhe e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej nga 6 (gjashtë) muaj i cili dënim i është shëndrruar në dënim me gjobë në lartësi prej 1300 (një mijë e treqind) €. Janë obliguar për pagesën e paushallit gjyqësor në shumë prej nga 20 €, si dhe nga 30 € për shpenzime të procedurës penale, kurse palëve të dëmtuara janë obliguar që ti kompensojnë dëmin e shkaktuar.

Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës

Gjykata e Apelit e Kosovës me aktgjykimin PA1.nr.1013/2018 të datës 28.12.2018, ka refuzuar si të pabazuara ankesën e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë dhe mbrojtësit të të dënuarit S.M. dhe aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit S.M. av. M.H. nga Mitrovica, për shkak të shkeljes së ligjit penal me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të ndryshoj aktgjykimet e kundërshtuara dhe të dënuarin ta liroj nga akuza ose t'i anuloj aktgjykimet e kundërshtuara dhe lënda të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Mendimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.88/2019 e datës 15.04.2019, ka propozuar që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

Pretendimet e paraqitura në kërkesë

Në kërkesë, mbrojtësi i të dënuarit, thekson se me aktgjykimet e kundërshtuara është shkelur ligji penal në dëm të të dënuarit pasi që për tu kryer vepra penale e falsifikimit duhet të vërtetohet fakti i dashjes direkte për të ndërruar, ndryshuar ose plotësuar ndonjë rrethanë në dokumentin zyrtar të lëshuar nga organi kompetent.

Pretendohet se i dënuari ka vepruar sipas kërkesave të qytetarëve si pasojë e humbjes së tabelave të regjistrimit të automjeteve dhe për shkak të procedurave të gjata nga ana e organit kompetent për tu pajisur me tabela të reja kanë improvizuar vetëm njërën tabelë bazuar në të dhënat e librezës së qarkullimit dhe njërës tabelë të mbetur, pra në asnjë rast nuk kemi të bëjmë me prodhimin e dy tabelave të improvizuara. Andaj duke u bazuar në këto rrethana në veprimet e të dënuarit nuk ekzistojnë elementet e veprës penale të falsifikimit pasi që nuk është përpiluar ndonjë dokument i rremë përkatësisht nuk është ndryshuar dokumenti origjinal me qëllim të përdoret si i vërtetë pasi që është fjala për një tabelë të regjistrimit të automjetit në përputhshmëri

të plotë me tabelën origjinale dhe librezën e qarkullimit dhe me këtë nuk është përmbushur elementi i dashjes si element konstituiv i veprës penale për të cilën i dënuari është shpallur fajtor.

Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

-kërkesa nuk është e bazuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimi i mbrojtësit të të dënuarit, është i pabazuar, ngase aktgjykimet kundër të cilave ka parashtruar kërkesë, nuk përmbajnë shkelje të ligjit penal për të cilat pretendohet.

Është e rëndësishme të theksohet fakti se në rastin konkret i dënuari ka bërë pranimin e fajësisë gjatë shqyrtimit fillestar dhe atë pas udhëzimeve të dhëna në këtë seancë, ashtu që në faqen e tretë të procesverbalit të shqyrtimit fillestar nga ana e gjyqtarit të gjykatës së shkallës së parë është konstatuar se pranimi i fajësisë nga ana e të dënuarit është bërë vullnetarisht, duke kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban akuza.

Gjykata e shkallës së parë në faqen e pestë të aktgjykimit të saj drejt ka konstatuar faktin se duke u bazuar në pranimin e fajësisë nga ana e të dënuarve dhe vlerësimin e provave që janë pjesë përbërëse e shkresave të lëndës ka vërtetuar se në veprimet e të dënuarve janë manifestuar të gjitha elementet e veprës penale në vazhdim falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par.1 lidhur me par.3 të KPRK-së e me këtë edhe aspektin e dashjes së të dënuarit për të përpiluar dokument të falsifikuar për tu përdorur si origjinal.

Gjykata Supreme e Kosovës, konstatoj se në rastin konkret është irelevant fakti se siç rezulton në disa raste është përpiluar vetëm njëra tabelë e regjistrimit dhe atë në përputhje me librezën e qarkullimit pasi që bazuar në nenin 60 të Ligjit për automjete 05/L-132 është përcaktuar se "*Pronari i mjetit duhet t'i ndërroj targat e regjistrimit me të reja nëse njëra nga*

targat i ka humbur, dëmtuar, shkatërruar, amortizuar deri në atë masë që bëhet e papërdorshme", ashtu që në këtë rast pronarët e automjeteve ka qenë dashur që për tabelën e humbur ta njoftojnë qendrën përkatëse të regjistrimit të automjeteve dhe pastaj të bëjnë ndërrimin e tabelave të regjistrimit të automjeteve të tyre bazuar në procedurat e përcaktuara ligjore.

Gjykata e shkallës së parë drejt ka zbatuar ligjin penal dhe nuk ka bërë shkelje të ligjit përkitazi pretendimin e paraqitur kur ka konstatuar se në veprimet e të dënuarit janë përmbushur të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale në vazhdim falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par.1 lidhur me par.3 të KPRK-së, meqë sipas pikëpamjes së Gjykatës Supreme të Kosovës në rastin konkret i dënuari nuk ka bërë ndryshimin apo plotësimin e ndonjë dokumenti, ashtu siç pretendohet në kërkesë, por i dënuari ka përpiluar dokumente të falsifikuara përkatësisht tabelat e regjistrimit dhe pastaj të njëjtat janë përdorur si origjinal nga ana e pronarëve të veturave.

Nga këto arsye, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë ishe e pabazuar dhe konform nenit 437 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË
Pml.nr.118/2019, më 14 maj 2019

B.profesional,
Sherif Krasniqi

Kryetarja e kolegjit,
Nesrin Lushta